



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
BORDI ADMINISTRIMIT
VENDIM

Nr. 4, datë 17.01.2019

MBI

“MIRATIM E KUFIRIT MAKSIMAL TË TARIFËS VJETORE TË SHKOLLIMIT, PËR STUDENTËT QË NDJEKIN STUDIMET NË NJË PROGRAM TË CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE, NË NJË PROGRAM TË INTEGRUAR TË STUDIMEVE OSE NË NJË PROGRAM TË STUDIMEVE PROFESIONALE ME KOHË TË PLOTË, NË FAKULTETET E UNIVERSITETIT TË ARTEVE”

Mbështetur në ligjin nr.80/2015, datë 22.07.2015 për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 288, datë 21.05.2018 “Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit, për studentët që ndjekin studimet në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë, në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë” (i ndryshuar); Bordi i Administrimit duke u bazuar në aktet e dala për këtë qëllim dhe pasi e diskutoi,

VENDOSI:

1. Miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit, për studentët që ndjekin studimet në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë, në Fakultetet e Universitetit të Arteve.
2. Për vitin akademik 2018-2019 e në vijim, studentët e Universitetit të Arteve do të paguajnë tarifën vjetore të shkollimit në masën 50%.
3. Ky vendim të përcillet pranë Ministrisë së Arsimit, Sportit e Rinisë.
4. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi, Fakultetet e Universitetit të Arteve dhe Drejtoria Ekonomike.
5. Publikimin e vendimit në faqen zyrtare (internet) të Universitetit të Arteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
UNIVERSITETI I ARTEVE
BORDI ADMINISTRIMIT

BORDI I ADMINISTRIMIT I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Elira KOKONA (Kryetar)

Prof. Artan PEQINI (Anëtar)

Prof. Arben BASHA (Anëtar)

Prof. Besnik BISHA (Anëtar)

Dhimitër BAKO (Anëtar)

Arjan KONOMI (Anëtar)

Erjon NDROQI (Anëtar)